



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

RAPORTI I AUDITIMIT PËR PASQYRAT FINANCIARE VJETORE TË KOMUNËS SË GRAÇANICËS PËR VITIN 2020

Prishtinë, korrik 2021

PËRMBAJTJA E RAPORTIT

1	Opinioni i auditimit.....	3
2	Gjetjet dhe rekomandimet.....	7
3	Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit.....	19
4	Progresi në zbatimin e rekomandimeve.....	22
	Shtojca I: Letër konfirmimi.....	27
	Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit.....	28

Shënim

Ky Raport i auditimit është gjeneruar për herë të parë përmes platformës elektronike për menaxhimin e auditimit (SITA). Po ashtu, këtë vit, përdoret shablloni i ri i Raportit të auditimit, sipas metodologjisë së përditësuar për auditime financiare dhe të pajtueshmërisë. Raporti përfshinë për herë të parë edhe konkluzionin e veçantë për pajtueshmëri.

Jemi plotësisht të vetëdijshëm që aplikimi i të gjitha këtyre risive njëkohësisht, në rrethana të pazakonshme të pandemisë, mund të rezultojë me ndonjë lëshim të paqëllimshëm teknik, për çka ju kërkohet falje paraprakisht dhe ju falënderojmë për mirëkuptim!

Për: Serdjan Popovic Kryetar i Komunës së Graçanicës

Adresa:Rr. Car Lazari Graçanicë 10500

1 Opinioni i auditimit

Ne kemi përfunduar auditimin e pasqyrave financiare të Graçanicës për vitin që përfundon më 31 Dhjetor 2020, në përputhje me Ligjin për Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës dhe Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Auditimi është kryer kryesisht për të na mundësuar të shprehim opinionin për pasqyrat financiare dhe konkluzionin për pajtueshmërinë me autoritetet(*)

1. Opinion i pamodifikuar për pasqyrat financiare

Ne i kemi audituar pasqyrat financiare vjetore të Komunës së Graçanicës, të cilat përmbajnë pasqyrën e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme, raportin e ekzekutimit të buxhetit si dhe shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare, përfshirë përmbledhjen e politikave të rëndësishme të kontabilitetit dhe raportet tjera(*), për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2020.

Sipas opinionit tonë, Pasqyrat Financiare Vjetore të Komunës së Graçanicës, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik, sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme.

Baza për opinion

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa e raportit 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

Konkluzion për pajtueshmërinë

Ne kemi audituar gjithashtu pajtueshmërinë e menaxhmentit të Komunës së Graçanicës me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Sipas konkluzionit tonë, transaksionet e kryera në procesin e ekzekutimit të buxhetit të Komuna e Graçanicës kanë qenë, në të gjitha aspektet materiale, në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin

e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Baza për konkluzion

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa e raportit 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për konkluzion..

Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe organeve drejtuese/qeverisëse për pasqyrat financiare vjetore

Zyrtar Kryesorë Financiarë është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të Pasqyrave Financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme. Po ashtu, Zyrtar Kryesorë Financiarë është përgjegjës edhe për vendosjen e kontrolleve të brendshme, të cilat i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e Pasqyrave Financiare, pa keq deklarime materiale të shkaktuara, qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë përmbushjen e kërkesave që burojnë nga Ligji nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë dhe Rregullorja nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizata Buxhetore..

Kryetar i Komunës së Graçanicës është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Komunës së Graçanicës .

Përgjegjësia e Menaxhmentit për Pajtueshmërinë

Menaxhmenti i Komunës së Graçanicës është gjithashtu përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare të Komunës së Graçanicës në përputhje me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësinë, dhe të gjitha rregullat dhe rregulloret e tjera të zbatueshme. (*)

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Objektivat tona janë të ofrojmë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi janë të lira nga keq-deklarime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, dhe të lëshojmë/hartojmë një raport të auditorit që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer në përputhje me SNISA-t gjithmonë do të zbulojë një keq-deklarim material kur ai ekziston. Keq-deklarimet mund të vijnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht

ose si tërësi, në mënyrë të arsyeshme pritet të ndikojnë në vendimet ekonomike të përdoruesve të marra në bazë të këtyre pasqyrave financiare.

Objektivi ynë është gjithashtu të shprehim një konkluzion të auditimit për pajtueshmërinë e autoriteteve përkatëse të Komunës së Graçanicës me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare, lidhur me subjektin e audituar.

Si pjesë e auditimit në përputhje me Ligjin për ZKA dhe SNISA-të, ne ushtrojmë gjykim profesional dhe mbajmë skepticizëm profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e keq-deklarimit material të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që i përgjigjen atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për opinionin tonë. Rreziku i mos zbulimit të një keq-deklarimi material që rezulton nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrolleve të brendshme.
- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e mos-pajtueshmërisë me autoritetet, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që janë përgjegjëse ndaj atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për konkluzionin tonë për pajtueshmërinë me autoritetet. Rreziku i mos zbulimit të një rasti të mos pajtueshmërisë me autoritetet që vjen nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrollit të brendshëm.
- Sigurohemi ta kuptojmë kontrollin e brendshëm relevant për auditimin, për t'i hartuar procedurat e auditimit që janë të përshtatshme, por jo me qëllim të shprehjes së një opinion mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të Komunës së Graçanicës.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave të kontabilitetit të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve të kontabilitetit dhe shpalosjet e ndërlidhura të bëra nga menaxhmenti.
- Vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë shpalosjet, për t'u siguruar se pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet themelore në mënyrë të drejtë dhe të saktë.


Ndër të tjera, ne komunikojmë me menaxhmentin dhe ata që janë përgjegjës për qeverisjen edhe në lidhje me fushëveprimin dhe kohën e planifikuar të auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi domethënëse në kontrollin e brendshëm që ne e identifikojmë gjatë auditimit.

Nga çështjet e komunikuara me menaxhmentin, ne përcaktojmë ato çështje që ishin më të rëndësishme në auditimin e Pasqyrave Financiare të periudhës aktuale dhe që cilësohen si çështje kyçe të auditimit. Raporti i auditimit publikohet në ueb faqen e ZKA-së, me përjashtim të informacioneve që klasifikohen si sensitive apo për shkak të ndalesave të tjera ligjore e administrative, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

2 Gjetjet dhe rekomandimet

Gjatë auditimit, kemi vërejtur fusha për përmirësim të mundshëm, përfshirë kontrollin e brendshëm, të cilat janë paraqitur më poshtë për shqyrtimin tuaj në formë të gjetjeve (siç janë paraqitur në Grafikon 1, më poshtë) dhe rekomandimeve. Këto gjetje dhe rekomandime kanë për qëllim të bëjnë korigjimin e nevojshëm të informacionit financiar të paraqitur në pasqyrat financiare, duke përfshirë shpalosjet në formë të shënimeve shpjeguese dhe të përmirësojnë kontrollet e brendshme lidhur me raportimin financiar dhe pajtueshmërinë me autoritetet në lidhje me menaxhimin e fondeve të sektorit publik. Ne do t'i përcjellim (shqyrtojmë) këto rekomandime gjatë auditimit të vitit të ardhshëm.

Grafiku 1. Lloji i gjetjeve sipas kategorive ekonomike



Ne po ashtu, kemi rishikuar statusin e rekomandimeve të vitit paraprak dhe kemi vlerësuar nivelin e zbatimit të tyre. [Për detajet shih kapitullin 4].

2.1 Gjetjet për çështjet e menaxhimit financiar dhe të pajtueshmërisë

2.1.1 Të hyrat

Komuna kishte planifikuar të hyra në vlerë prej 2,245,600€, kurse realizimi ishte në vlerë prej 2,317,163€ apo në masën prej 103%. Ato kanë të bëjnë me tatimin në pronë, të hyrat nga lejet e ndërtimit të hyrat nga taksat në biznes etj. Po ashtu, Komuna këtë vit ka pranuar edhe të hyra indirekte nga gjobat e trafikut në vlerë totale prej 131,057€.

Çështja B1 - Faturim jo sipas zonës reale (Rregullores)

Gjetja Neni 2 i Rregullores nr. 05/19/ Komunës së Graçanicës për aplikimin e tatimit në prone (e miratuar me 26 Nëntor 2019) i ka përcaktuar katër zona të qytetit.

Komuna në pesë raste ka ngarkuar me tatim me të lart taksapaguesit për shkak se nuk i janë përmbajt rregullores komunale apo zonave tatimore të përcaktuar në këtë rregullore. Vlera te tatimpaguesit që ka ndodhur mbi faturimi duhet të jetë në shumë prej 41,166€, e jo siç është prezantuar në faturën (kartelën financiare) sipas Komunës në shumë prej 54,596€. Pra kemi mbi faturim prej 13,430€. Këto zona me rregullore i përkasin zonës së dytë, mirëpo sipas të dhënave (në kartelën financiare dhe protax) këto raste janë faturuar sipas zonës së katërt.

Sipas zyrtarëve përgjegjës komunal, në sistemin e tatimit në pronë Pro-tax në tri zonat kadastrale nuk figuron rruga “Magjistranja Prishtine-Ferizaj” (edhe pse kalon nëpër tri fshatra Çagllavicë, Llapnasell dhe Preoc si zona të përcaktuar në rregulloren) po ashtu nuk është parapara as në Rregulloren e tatimit në pronë.

Ndikimi Mos vendosja e zonave reale tek protaxi për faturimin e tatimit në pronë në përputhje me zonat e përcaktuara sipas Rregullores, ka për pasojë mbi-faturimin apo dëmtimin e tatimpaguesit, e cila mund të përcillet dhe me proceduara ankimore në të ardhmen.

Rekomandimi B1 Kryetari duhet të siguroj se behën korigjimet e nevojshme mbi të dhënat e zonave të vendosura në sistemin-protax, në përputhje me Rregulloren në fuqi, në mënyrë që ngarkesa tatimore të jete e saktë dhe e drejt për të gjithë obliguesit e tatimit në pronë.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.1.2 Mallrat dhe shërbimet

Buxheti final për mallra, shërbime dhe komunalishte ishte 2,676,216€, prej tyre ishin shpenzuar 2,513,748€. Ato kanë të bëjnë me mirëmbajtjen e rrugëve, furnizime mjekësore, furnizime me pajisje, material zyrtar, shërbime kontraktuese tjera, mirëmbajtje të objekteve, mirëmbajtje të automjeteve, shpenzime komunale, etj. Ne kemi testuar 16 mostra në vlerë totale 767,402€ përmes testimit substancial dhe pesë mostra apo procedura të prokurimit në vlerë 421,080€ përmes testeve të pajtueshmërisë.

Çështja B2 – Çertifikim për pagesë për lëndë jo të kompletuara dhe vonesë në pagesë të obligimeve

Gjetja Neni 22 i Rregullës Financiare për Shpenzimin e Parave Publike ka përcaktuar kërkesat që OB duhet të zbatojnë për shfrytëzimin e parasë publike, dhe hapat për procedim të pagesave. Po ashtu me këtë Rregull dhe me LMFPF është përcaktuar që obligimet financiare ndaj kontraktuesve duhet të paguhën brenda 30 ditëve nga data e pranimit të faturës.

Në dy pagesa në vlerë totale prej 30,908€ për “shërbimet e pastrimit” sipas kontratës me kompaninë publike, në lëndën për pagesë mungonin faturat për shpenzimet e paguara. Në vend të faturës kontraktuesi kishte dorëzuar vetëm specifikacionet për shërbimet e kryera/mirëmbajtjes/pastrimit të specifikuar në vlerë dhe sasi. Ndërsa, në lëndën për shërbime hoteliere në vlerë 1,410€, përveç faturës dhe kërkesave për pagesë mungonte raporti përcjellës lidhur me qëllimin, agjendën dhe zyrtarët që kanë shfrytëzuar shërbimet e hotelierisë.

Po ashtu, në gjashtë pagesa kemi gjetur se obligimet financiare në vlerë totale 216,906€ ishin paguar pas afatit kohor ligjor prej 30 ditëve me vonesa prej 30-115 ditë, ndërsa në 10 raste zotimi i mjeteve në SIMFK ishte bërë pas pranimit të faturës apo pranimit të mallrave apo shërbimeve.

Shkaku përse ka ardhur deri kjo situatë, është kontrolli i brendshëm i pamjaftueshme në procesin e certifikimit të pagesave dhe zotimit të mjeteve në SIMFK.

Ndikimi Çertifikimi i pagesës në mungesë të faturës ndikon që komuna të mos ketë informata të mjaftueshme për shërbimet e pranuar si dhe çmimin/vlerën për ato shërbimet. Po ashtu edhe zotimet e pa mjaftueshme krijojnë vonesa në shlyerjen e obligimeve dhe vonesat në pagesën e obligimeve mund të bartin kosto shtesë buxhetore në rast të padive nga kontraktuesit.

Rekomandimi B2 Kryetari duhet të sigurojë se çertifikimi i pagesave bëhet vetëm pasi lëndët të jenë kompletuar me dokumentacionin e nevojshëm. Obligimet financiare të paguhen brenda afatit ligjor, dhe se zotimi i mjeteve financiare në SIMFK ti paraprijë kërkesave për furnizim të mallrave dhe shërbimeve.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A1- Menaxhim jo i rregullt i kontratave publike

Gjetja Me pikën 61 të Rregullës dhe Udhëzuesit Operativ për Prokurimin Publik janë përcaktuar përgjegjësit e menaxherit të kontratës. Menaxheri i Kontratës ka përgjegjësi të menaxhoj obligimet dhe detyrat e Autoritetit Kontraktues të specifikuara me kontratë, dhe b) sigurojë se operatori ekonomik kryen kontratën në përputhje me termet dhe kushtet e specifikuar në kontratë. Gjithashtu, UA nr. 15/2013 – përcakton kërkesat dhe kushtet për mbajtjen e librit dhe ditarit ndërtimor nga organi mbikëqyrës i punimeve.

Te kontrata për “Pastrimin, larjen e rrugëve dhe trotuareve, mirëmbajtjen dimërore të rrugëve dhe pastrime të ndryshme në Komunën e Graçanicës,” të bëra në muajin mars dhe prill në vlerë totale prej 294,390€ ishin faturuar dhe paguar me vonesë, nga të cilat 36,654€ ishin paguar në muajin gusht dhe 256,760€ në muajin dhjetor. Për furnizimet me krip dhe rërë në vlerë 62,020€ në ditarin ndërtimor nuk ishte evidentuar sasia e furnizuar, për ta arsyetuar sasinë e paguar. Për më tepër, kripa dhe rëra ishte pranuar në muajin prill, ndonëse nuk arsyetohet nevoja për furnizim për shkak të kalimit të sezonit të dimrit dhe përmirësimit të kushteve klimatike.

Te pagesa për “Shërbimet e Pastrimit dhe Higjienës Publike” në vlerë 16,544€, shërbimet për një pozicion nuk ishin realizuar (Lagja e Hashanëve) përderisa në raportin e menaxherit të kontratës vetëm ishte përshkruar që shërbimet e pastrimit nuk janë realizuar, por pa dhënë arsytet e mos realizimit të shërbimeve. Situacioni i punimeve nuk ishte nënshkruar nga menaxheri i kontratës por vetëm nga shërbimi financiar i kompanisë pastruese. Nuk na janë ofruar dëshmi të mbikëqyrjes dhe vizitave në teren nga mbikëqyrësi i kontratës, ndonëse me nenin 10 të Marrëveshjes kërkohet një gjë e tillë. Kompania kontraktuese për shërbimet e ofruara ka përfshirë në faturë përveç çmimit të dhënë në shtojcën D, edhe pjesën prej 8% në emër të TVSH-së, në vlerë 1,226€. Neni 14 i Marrëveshjes trajton pjesën e TVSH-së, por nuk e qartëson nëse kjo

shtesë është pjesë përbërëse e çmimit të kontraktuar të dhënë në shtojcën D të Marrëveshjes, apo do të kalkulohet mbi çmimin e ofertuar, si vlerë shtesë.

Sipas shpjegimeve të zyrtarëve të komunës, faturimi dhe pagesa me vonesë është shkak i mungesës së mjeteve buxhetore, ndërsa mangësitë në lidhje me pranimin e furnizimeve dhe shërbimeve janë rezultat i mangësive në mbikëqyrje të kontratave.

Ndikimi Mangësitë aktuale mund të shkaktojnë paqartësi lidhur me shërbimet e ofruara dhe nevojën e furnizimeve. Definimi i paqartë i çmimit të kontraktuar, krijon parakushte për kosto shtesë buxhetore.

Rekomandimi A1 Kryetari duhet të sigurojë se menaxherët e kontratave mbikëqyrin dhe evidentojnë në raportet e pranimin dhe ditarin e punës sasinë e furnizimeve dhe shërbimeve të kryera. Kryetari në bashkëpunimin me kompaninë kontraktuese duhet të qartësojë aspektin e çmimit të kontraktuar dhe ti përmbahet çmimeve të kontraktuara sipas Marrëveshjes.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A2 – Klasifikim jo adekuat i shpenzimeve dhe regjistrim jo adekuat në kode ekonomike

Gjetja Sipas nenit 18, pika 3 e rregullores 01/2013/MF për Shpenzimin e Parasë Publike, shpenzimet duhet të kenë kodet adekuate, të përcaktuara me Udhëzimin Administrativ për planin kontabël. Në planin kontabël të Thesarit janë përcaktuar kodet dhe kategoritë përkatëse të shpenzimeve që OB duhet të aplikojnë.

Pagesa në vlerë prej 23,750€ për furnizim me material shëndetësor për sektorin e shëndetësisë dhe mirëqenies sociale (covid-19) ishte regjistruar në kategorinë e subvencioneve dhe transfereve përderisa ky shpenzim i takon kategorisë së mallrave dhe shërbimeve përkatësisht kodit ekonomik për furnizime mjekësore.

Po ashtu, edhe pagesat në vlerë totale prej 49,662€ për furnizim me pelet dhe dru ishin regjistruar në kodin ekonomik jo adekuat 13460 - shërbime kontraktuese tjera.

Shkaku i kësaj ishte mungesa e kontrollit dhe mbikëqyrjes në zotimin e mjeteve në kategorinë përkatëse ekonomike.

Ndikimi Pagesat e bëra nga kategoritë dhe kodet ekonomike jo-adekuate, ndikojnë në keq klasifikimin e shpenzimeve duke mbivlerësuar/nënvlerësuar kategoritë përkatëse të shpenzimeve dhe rrjedhimisht në prezantim jo të drejtë të shpenzimeve në PFV-ve.

Rekomandimi A2 Kryetari duhet të sigurojë se të gjitha shpenzimet regjistrohen në kategoritë dhe kodet përkatëse ekonomike.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.1.3 Subvencionet dhe transferet

Buxheti final për subvencione dhe transfere ishte 480,845€, prej tyre ishin shpenzuar 139,286€. Ato janë shpenzuar kryesisht për financim për entitete publike dhe jo publike, përfituese individual, OJQ të ndryshme etj. Kemi testuar pesë mostra në vlerë totale 60,000€, duke aplikuar teste substanciale dhe teste të pajtueshmërisë. Mangësitë e identifikuara kanë të bëjnë:

Çështja A3 – Parregullsi në procesin e subvencionimit të OJQ-ve

Gjetja Rregullorja MF-04/2017-“Për subvencionimin e OJQ-ve”, ka përcaktuar procedurat, kërkesat dhe kriteret për subvencionimin. Përmes kësaj rregullore janë përcaktuar formularët dhe raportet që OB duhet të aplikojnë përgjatë tërë procesit të subvencionimit. Gjithashtu, Komuna e Graçanicës ka të aprovuar Rregulloren për Subvencione përmes se cilës janë përcaktuar kërkesat dhe procedurat për subvencionim. Me nenin 15, pika 2, është përcaktuar që përfituesit nuk duhet të kenë obligime financiare të papaguara ndaj Komunës.

Me Thirrjet Publike është kërkuar që pas nënshkrimit të kontratës, përfituesi duhet të paraqesë prova se personi përgjegjës i organizatës (përfituese) dhe menaxheri i projektit nuk janë nën hetime për vepra penale. Zyrtari kryesor administrativ duhet të caktojë personat përgjegjës të Komunës për monitorimin e secilës faze të subvencionimit.

Rezultatet e testimeve tregojnë se:

- Te subvencionimi i projektit “Zhvillimi dhe Promovimi i Turizmit në Komunën e Graçanicës” në vlerë 40,000€, kemi identifikuar se: Përfituesi i subvencionit nuk kishte sjellë dëshmi nga gjykata se menaxheri i projektit dhe personi përgjegjës i OJQ-së nuk janë nën hetime për vepra penale. Nga Komuna nuk ishte caktuar mbikëqyrës

për monitorimin e realizimit të projektit dhe përfituesi nuk kishte ofruar dëshmi që nuk ka obligim financiar të papaguar ndaj Komunës.

- Te subvencionimi i projektit “Shënimi i Ditës së Komunës së Graçanicës” në vlerë 6,000€, kemi identifikuar se: Dokumentet/formularët e aplikimit ishin të pa nënshkruara nga përfaqësuesi i autorizuar i OJQ-së përfituese dhe nga menaxheri i projektit/udhëheqësit, si dhe nuk ishin të plotësuara siç kërkohet me rregulloren për financim të OJQ-ve, edhe pse i njëjti projekt ishte aprovuar nga Komisioni vlerësues. Përfituesi i subvencionit nuk kishte sjellë dëshmi nga gjykata se menaxheri i projektit dhe personi përgjegjës i organizatës nuk janë nën hetime për vepra penale.
- Te projekti për “Zhvillimin i Bujqësisë dhe Rritja e Aktivitetit Bujqësor” në vlerë 11,000€, kemi identifikuar se: Aplikacionit i mungonte Deklarata mbi financimin e dyfishtë dhe Deklarata mbi projektet e financuara nga burimet publike. Përfituesi i subvencionit nuk kishte sjellë dëshmi nga gjykata se menaxheri i projektit dhe personi përgjegjës i organizatës nuk janë nën hetime për vepra penale. Nuk është ofruar dëshmi se përfituesi nuk ka ndonjë obligim financiar ndaj Komunës. Zyrtari Çertifikues (alternativ) që kishte certifikuar pagesën për këtë subvencionim, ishte edhe anëtar i Komisionit vlerësues të kërkesës për subvencionim.

Shkaku i kësaj, është mungesa e kontrolleve adekuate për të monitoruar procesin e vlerësimit të kërkesave dhe monitorimit të realizimit të projekteve.

Ndikimi

Mos zbatimi i të gjitha kërkesave të rregullores mund të krijojë parakushte që procesi i subvencionimit të mos zhvillohet si duhet dhe të mos arrihen objektivat e synuara.

Rekomandimi A3

Kryetari duhet të sigurojë se procesi i përzgjedhjes së projekteve për financim të zhvillohet duke aplikuar të gjitha kërkesat dhe formatet/formularët standard të përcaktuara me Rregulloren MF-Nr. 04 2017 për subvencionim të OJQ-ve, si dhe duhet të shtojë masat e kontrollit në monitorimin e projekteve të financuara. Ndarja e detyrave dhe përgjegjësive të bëhet në pajtim me rregullat e MFK-së ashtu që zyrtarët të mos përfshihen në më shumë se në një fazë të procesit.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.1.4 Investimet kapitale

Buxheti final për investime kapitale ishte 5,840,132€, prej tyre ishin shpenzuar 5,340,249€. Investimet kapitale kanë të bëjnë kryesisht me rregullim të infrastrukturës, qendrave sociale, ndërtimin e çerdhes për fëmijë, si dhe përmirësime të ndryshme tek objektet dhe inventari etj. Kemi testuar 43 mostra për teste substanciale në vlerë 4,109,710€, si dhe pesë mostra për teste të pajtueshmërisë.

Çështja A4 – Nënshkrimi i kontratave përtej vlerës së parashikuar të buxhetit

Gjetja Sipas nenit 9 pika 3 të LPP-së – “Nëse autoriteti kontraktues është autoritet publik ose organizatë buxhetore dhe prokurimi përkatës do të shkaktojë ngritjen e obligimeve financiare të cilat do të përmbushen nga ndarjet buxhetore që pritet të bëhen në vitet e ardhshme fiskale, ZKF do të (i) sigurojë që tabelat e bashkëngjitura Ligjit për Ndarjet Buxhetore ofrojnë bazë të arsyeshme për të pritur se në vitet a ardhshme fiskale do t’i ofrohen fonde të mjaftueshme për përmbushjen e obligimeve të tilla.” Lidhur me këtë ne kemi identifikuar:

- Projekti “Rehabilitimi I lumenjve, mureve mbrojtëse, urave dhe rrugëve lokale të Komunës e Graçanicës” vlera e parashikuar dhe e buxhetuar për tri vite (2019,2020,2021) sipas tabelave të buxhetit (PIP) ishte 1,378,928€, ndërsa kontrata ishte lidhur në vitin 2019 me vlerë 2,996,324€ apo 1,617,396€ më lartë se vlera e parashikuar. Po ashtu edhe me Ligjin e buxhetin 2020 nuk ishin destinuar mjete të mjaftueshme për realizimin e këtij projekti. Pagesa për këtë projekt për vitin 2020 janë bërë 465,378€.
- Projekti “ Rindërtimi rehabilitimi dhe përmirësimin e rrjetit të ujësjellësit dhe kanalizimit ne territorin e Komunës se Graçanicës”, vlera e parashikuar dhe e buxhetuar për tri vite (2020,2021,2022) sipas tabelave të buxhetit (PIP) ishte 300,000€, ndërsa kontrata ishte lidhur në vitin 2020 me vlere 697,214€ apo 397,214€ me e lartë se vlera e parashikuar. Edhe me ligjin e buxhetit 2021 mjetet e destinuara nuk ishin të mjaftueshme për ta realizuar këtë projekt.

Mangësitë e përmendura më lartë kanë ndodhur si pasojë e planifikimit jo të mirë të projekteve dhe në mungesë të një analize paraprake të mirëfilltë të kostove për këto projekte.

Ndikimi Hyrja në obligime kontraktuale nga komuna përtej mundësive buxhetore dhe në kundërshtim me ligjin, rrezikon mbarëvajtjen dhe implementimin e projekteve tjera. Po ashtu kjo situatë mund të krijon kosto shtesë për komunën pasi që nga pamundësia e kryerjes së obligimeve mund të jetë subjekt i procedurave gjyqësore.

Rekomandimi A4 Kryetari duhet të siguroj që nënshkrimi i kontratave bëhet në përputhje me fondet e buxhetuara dhe aprovuar, në mënyrë realizimi i projekteve të jetë sipas planit për të parandaluar shpenzime tjera shtesë.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.1.5 Pasuritë kapitale dhe jokapitale

Vlera e paraqitur në PFV e pasurive kapitale është 20,289,475€, pasurive jokapitale është 332,650€, si dhe e stoqeve 4,949€. Kemi testuar 70 mostra për teste substanciale në vlerë prej 4,651,309€.

Çështja C1 - Mos përgatitja e raportit të inventarizimit para finalizimit të PFV-ve

Gjetja Sipas Rregullores me Nr. 02/2013 – “Për menaxhimin e pasurisë jo financiare në organizatat buxhetore”, neni 19 paragrafet 4.6 dhe 4.7, kërkojnë që komisioni i inventarizimit të përgatitë raportin për kryerjen e inventarizimit si dhe hartimi i raportit të përgjithshëm në bazë të raporteve individuale të komisionit për inventarizimin e pasurive jo financiare në kohën e përshtatshme para përgatitjes së pasqyrave financiare vjetore. Ky proces duhet të paraprij përgatitjes së PFV.

Gjatë vitit 2020 komisioni për inventarizim të pasurive ishte formuar me vendim të kryetarit të komunës më dt.10.09.2020. Mirëpo, komisioni nuk kishte përgatitur ndonjë raport për gjendjen e inventarizimit para përgatitjes së PVF. Komisioni punën e kishte kryer me dt.08.02.2021 dhe me këtë datë e kishte përgatitur raportin.

Shkaku përse ka ndodhur kjo është se komisioni nuk ishte në gjendje të ofroj dëshmi se ka përfunduar punën sipas kërkesave ligjore.

Ndikimi Mos përgatitja e raportit të inventarizimit brenda afatit të paraparë ligjor, ndikon që prezantimi i pasurisë në regjistrat e komunës dhe në pasqyrat financiare vjetore të mos jetë i saktë dhe i plotë, po ashtu rrezikon humbjen apo përvetësimin e pasurisë.

Rekomandimi C1 Kryetari duhet të siguroj që komisioni për inventarizim të pasurisë të hartojë raportin për inventarizimin e pasurive para datës së përgatitjes së PFV-ve.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B3 – Mos funksionimi i sistemit e-Pasuria

Gjetja Sipas Rregullores Nr. 02/2013 - “Për menaxhimin e pasurisë jo financiare në organizatat buxhetore”, neni 6, pasuria kapitale duhet të regjistrohet në SIMFK ndërsa pasuria jo kapitale dhe stoqet duhet të regjistrohen në sistemin “e-pasuria”.

Përkundër rekomandimit nga vitit i kaluar, sistemi e-Pasuria ende është jo funksional. Të dhënat për pasuritë nën 1,000€ mbahen në data bazë të brendshme në formatin Excel, i cili nuk kalkulon amortizimin e pasurive dhe si i tillë mbivlerëson vlerën e tyre në PFV. Për ta rregulluar këtë çështje, komuna kishte bërë kërkesë në MAP mirëpo nuk ishte bërë asgjë në lidhje me këtë.

Sipas menaxhmentit, pritet që gjatë vitit 2021 të përcjellin tabelën e migrimit me të dhënat e plotësuara dhe të fillojnë me regjistrimin e pasurive jo kapitale për vitin 2020 në sistemin e-Pasuria.

Ndikimi Mos vënia në funksion e sistemit e-pasuria dhe raportimi i pasurive nën 1,000€ nga formati Excel i cili nuk kalkulon amortizimin ndikon në mbivlerësimin e vlerës së pasurive në PFV. Njëherë pamundëson një menaxhim dhe kontroll efektiv mbi pasuritë e saj.

Rekomandimi B3 Kryetari duhet të marrë veprime të nevojshme për ta aplikuar sistemin e menaxhimit të pasurisë (e-pasuria), në mënyrë që të ketë një menaxhim dhe raportim të pasurisë në përputhje me kërkesat e rregullores për menaxhimin e pasurisë jo financiare. Kjo çështje duhet të trajtohet edhe nga MAP, në mënyrë që ti mundësohet komunës që të funksionalizoj sistemin e-pasuria.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A5 - Parregullsi në menaxhim të automjeteve zyrtare**Gjetja**

Ne Udhëzimin nr. 5419/2015, për përdorimin e automjeteve zyrtare të komunës së Graçanicës, neni 5, pika 3, përcaktohet që të punësuarit në rastin e përdorimit të automjeteve zyrtare duhet të kenë urdhëresën/ fletudhëtimin e plotësuar, i cili miratohet nga udhëheqësi përgjegjës. Po ashtu neni 7, përcakton përmbajtjen e fletudhëtimit për përdorimin e automjetit, si: emri i shfrytëzuesit, emri i aprovuesit, drejtoria, data, lokacioni, qëllimi, nënshkrimet etj. Neni 15, pika 1, Automjetet zyrtare mund të përdoren për udhëtime zyrtare edhe jashtë territorit të Kosovës, me një miratim dhe një urdhër për udhëtim zyrtar të nënshkruar nga udhëheqësi përgjegjës. Për përdorimin e automjetit zyrtar jashtë territorit të Kosovës, fletë udhëtimi duhet të aprovohet nga Kryetari i Komunës. Kemi identifikuar se menaxhimi i automjeteve është përcjell me disa parregullsi si në vijim:

- Në nëntë raste kemi identifikuar se nuk aplikohet kërkesat nga punonjësit për shfrytëzim apo përdorim të automjetit zyrtar dhe aprovimet nga udhëheqësi përgjegjës. Gjithashtu mungonin kërkesat dhe aprovimet për përdorimin e automjeteve jashtë vendit, si dhe nuk ka evidenca për qëllimin e udhëtimit të tyre Mbahet vetëm një regjistër mujor i udhëtimit ku evidentohet destinacioni i udhëtimit dhe evidenca e kilometrave, por jo edhe qëllimi i udhëtimit dhe nga kush është shfrytëzuar shërbimi i udhëtimit. Fletë udhëtimi mujor nënshkruhet nga vozitësi, por jo edhe nga zyrtarët që kërkojnë shërbime të transportit;
- Nuk ka ndonjë vendim për caktimin e zyrtarëve që mund të bëjnë furnizimin me derivate, furnizimi me derivate bëhet nga zyrtar të ndryshëm, ndonëse me neni 11 të Udhëzimit është përcaktuar që me derivate mund të furnizohen vetëm personat e caktuar zyrtar (shefi i shërbimit të transportit); dhe
- Nuk aplikohen kërkesat dhe aprovimet nga niveli përgjegjës për mirëmbajtjen (shefi i shërbimit të transportit) apo dërgimin e automjeteve në riparim.

Shkak i kësaj është mungesa e kontrolleve adekuate në menaxhimin dhe shfrytëzimin e automjeteve zyrtare.

Ndikimi Përdorimi i pa kontrolluar i automjeteve ofron mundësin që automjetet të përdoren edhe për qëllime jo zyrtarë. Po ashtu mungesa e kontrollit për furnizim me derivate dhe riparim të veturave zyrtarëve mundësojnë shpenzime të pa kontrolluar apo kosto të pa nevojshme për komunën.

Rekomandimi A5 Kryetari duhet të sigurojë se menaxhimi i automjeteve kontrollohet nga personat përgjegjës të emëruar paraprakisht të cilët aplikojnë dokumente dhe aprovojnë kërkesat sipas rregullave duke ofruar dëshmi përkatëse se veturat përdoren për nevoja të komunës. Furnizimi me derivate të bëhet në mënyrë të kontrolluar apo nga personat e paracaktuar dhe nevojës për riparim të automjeteve duhet ti paraprijë kërkesa dhe bashkëngjitet aprovimi nga niveli përgjegjës.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit

Ne kemi marrë parasysh burimet e fondeve buxhetore, shpenzimin e fondeve dhe të ardhurave të mbledhura nga kategoritë ekonomike. Kjo është theksuar në tabelat e mëposhtme:

Tabela 1. Shpenzimet sipas burimeve të fondeve buxhetore (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final ⁵	2020 Shpenzimet	2019 Shpenzimet	2018 Shpenzimet
Burimet e fondeve	10,661,327.00	12,274,748.89	11,270,839.22	9,065,732.70	7,652,621.66
Grante Qeveritare – Buxheti	6,314,161.00	6,663,639.39	6,355,103.00	5,835,034.91	5,898,107.93
Financimi përmes huamarrjes	0.00	114,030.00	114,030.00	0.00	0.00
Financimi përmes huamarrjes – klauzola e investimeve	2,560,000.00	2,560,000.00	2,559,741.20	1,488,821.55	0.00
Të bartura nga viti i kaluar	0.00	631,888.46	603,625.76	584,483.24	747,504.89
Të hyrat vetanake	1,787,166.00	2,245,600.33	1,580,029.10	1,157,393.00	997,487.84
Donacionet e jashtme	0.00	59,590.71	58,310.16	0.00	9,521.00

Buxheti final është më i lartë se buxheti fillestar për 1,613,421€. Kjo rritje është rezultat i të hyrave të bartura nga viti i kaluar prej 631,889€, si dhe rritja e buxhetit për shkak të tejkalimit të të hyrave vetanake për 458,434, nga granditë e qeverisë 463,507€ si nga donacionet e jashtme 59,591€.

Në vitin 2020 Komuna ka shpenzuar 92% të buxhetit përfundimtar në 2020 ose 11,270,839 €, me një përmirësim 24% në krahasim me vitin 2019 që ishte vetëm 68%. Megjithatë, se si është realizuar buxheti në nivel të kategorive, janë dhënë shpjegimet në tabelën më poshtë:

Tabela 2 – Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike - (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2020 Shpenzimet	2019 Shpenzimet	2018 Shpenzimet
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike	10,661,327.00	12,274,748.89	11,270,839.22	9,065,732.70	7,652,621.66
Pagat dhe mëditjet	2,982,483.00	3,277,555.79	3,277,555.79	2,959,569.94	2,833,158.66
Mallrat dhe Shërbimet	1,325,289.00	2,347,716.39	2,207,390.19	1,269,444.61	729,505.05
Komunalit	180,000.00	328,500.00	306,358.35	138,142.84	137,764.44
Subvencionet dhe Transferet	180,859.00	480,844.60	139,285.60	190,660.16	209,567.24
Investimet Kapitale	5,105,217.00	5,840,132.11	5,340,249.29	4,507,915.15	3,742,626.27
Rezervat	887,479.00	0.00	0.00	0.00	0.00


Shpjegimet për ndryshimet në kategoritë e buxhetit janë dhënë më poshtë:

- Buxheti final për kategorinë e pagave dhe mëditjeve në raport me atë fillestar është rritur për 295,072€, kjo ka ndodhur me vendim të qeverisë për mbulimin e pagave dhe mëditje (pagat shtesë për menaxhimin e pandemisë), buxheti final ishte shpenzuar 100%;
- Te kategoria e mallrave dhe shërbimeve buxheti final në raport me atë fillestar është rritur për 1,022,427€, rritja është nga të hyrat e bartura për 681,322€, nga rezerva në vlerë prej 335,831€ (kryesisht për shpenzimet tek mirëmbajta e rrugëve, karburantet për vetura, furnizim mjekësorë dhe pajisje nën 1,000€, shërbim kontraktuale tjera etj.) dhe nga donacionet e jashtme vlera prej 5,274€, buxheti final ishte shpenzuar 94%;
- Në kategorinë e subvencioneve dhe transfereve kemi rritje të buxhetit final për 299,986€ nga të hyrat e bartura nga viti i kaluar vlera 15,000€, si dhe 284,986€ janë pranuar nga MAPL për pandemin Covid-19. Përkundër kësaj rritje realizimi i buxhetit ishte shumë i ulët vetëm 29% e buxhetit final ishte shpenzuar pasi që disa projekte që ishin destinuar për menaxhim të pandemis/ rimëkëmbje ekonomike janë anuluar në fund të vitit;
- Po ashtu, edhe buxheti final te kategoria e investimeve kapitale ishte rritur për 734,915€, si rezultate i të hyrave të bartura nga viti i kaluar në vlera prej 389,000€, nga rezerva 291,600€, si dhe donacioneve të jashtme me vlerë 54,315€, buxheti final ishte realizuar 91%; dhe
- Buxheti final në raport me atë fillestarë te kategoria e rezervës ka mbetur zero, ky buxhet ishte shpërnda në paga dhe mëditje 116,550€, mallra dhe shërbime 335,831€, shpenzime komunale 143,498€, si dhe për investime kapitale 291,600€.


Detyrimet kontraktuale të raportuara nga ana e Komunës në fund të vitit 2020 janë në vlerë prej 5,276,469€(*).

Për menaxhimin e pandemisë Covid-19 komuna kishte shpenzuar buxhet në vlerë prej 377,605€, prej tyre 357,420€ ishin për shtesa në paga si dhe 20,185€ subvencione.

Grafiku 2. Shpenzimet sipas kategorive ekonomike gjatë periudhës 2018-2020



Grafiku 3. Shpenzimet sipas kategorive ekonomike për vitin 2020



Të hyrat e realizuara nga Komuna në 2020 ishin në vlerë 2,317,164€. Ato kanë të bëjnë me tatimin në pronë, të hyrat nga taksa për ushtrimin e veprimtarisë etj. Po ashtu, komuna këtë vit ka pranuar edhe të hyra nga gjobat nga trafiku, në vlerë totale prej 131,057€, këto të hyra nuk janë të përfshira në tabelën e mëposhtme për arsye se këto i planifikojnë dhe realizojnë ministritë e linjës.

Tabela 3. Të hyrat(në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2020 Pranimet	2019 Pranimet	2018 Pranimet
Totali i të hyrave	1,787,166.00	2,245,600.33	2,317,163.95	1,624,676.23	1,531,241.85
Të hyrat tatimore	600,303.00	600,303.00	676,147.43	603,415.50	582,637.72
Të hyrat jo tatimore	1,186,863.00	1,645,297.33	1,641,016.52	1,021,260.73	948,604.13

4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti i auditimit për PFV-të të vitit 2019 të ka rezultuar në shtatë rekomandime. Komuna kishte përgatitur një Plan Veprimi ku paraqitet mënyra se si do t'i zbatoj rekomandimet e dhëna. Po ashtu komuna ka përgatitur edhe progresin rreth zbatimit të rekomandimeve.

Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2020, dy rekomandime janë zbatuar, një ishte në proces, tri nuk janë zbatuar ende dhe një konsiderohet si i mbyllur, siç është paraqitur në Grafikon 4, më poshtë. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrën se si janë trajtuar ato, shihni në Tabelën 4 (ose Tabelën e rekomandimeve).

Grafiku 2. Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak




Tabela 4 Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak dhe vitit 2019

Nr.	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2019	Veprimet e ndërmarra	Statusi
1	PFV	Kryetari duhet të sigurojë që janë ndërmarrë të gjitha veprimet që shpenzimet të planifikohen në ndarjet adekuate të buxhetit apo ridestinin të mjeteve dhe që pagesa dhe regjistrimi i shpenzimeve bëhet sipas kodeve ekonomike adekuate.	Kjo çështje do të trajtohet në Raportin vjetor të auditimit RVA.	Nuk është i aplikueshëm më
2	Te hyrat	Kryetari duhet të siguroj që zonat e aprovuara me rregulloren për tatimin në pronë e paluajtshme janë azhurnuar në sistemin e tatimit në pronë, para se të bëhet faturimi në mënyrë që mos të dëmtohet komuna, por edhe qytetarët si tatim pagues.	Komuna nuk kishte arrite ta zgjedhë këtë rekomandim.	Nuk ka filluar zbatimin
3	Mallrat dhe shërbimet	Kryetari duhet të sigurojë që specifikimet teknike të përgatiten në pajtueshmëri të plotë me legjislacionin specifik që është në fuqi, duke mos përdorur emrin e markës tregtare apo modelit që favorizon apo diskriminon ndonjë OE.	Komuna kishte marrë masa për ta adresuar këtë çështje.	I zbatuar
4	Pasuritë kapitale dhe jo kapitale	Kryetari duhet të siguroj që komisioni për inventarizim të pasurisë ka përfunduar punën duke hartuar raportin për inventarizimin e pasurive si dhe pastaj këtë ta harmonizoj me PFV e komunës.	Komuna pjesërisht kishte marrë masa për ta zbatuar këtë rekomandim	Rekomandim pjesërisht i zbatuar
5	Pasuritë kapitale dhe jo kapitale	Kryetari, duhet të marrë veprimet e nevojshme për ta aplikuar sistemin e menaxhimit të pasurisë (e-pasuria), në mënyrë që të ketë një menaxhimin dhe raportim të pasurisë në përputhje me kërkesat e rregullores për menaxhimin e pasurisë jo financiare. Kjo çështje duhet të trajtohet edhe nga MAP, në mënyrë që ti mundësohet komunës që të funksionalizoj sistemin e-pasuria.	Komuna nuk kishte arritur ta zgjedhë këtë rekomandim.	Nuk ka filluar zbatimin
6	Te arketueshmet	Kryetari, duhet të ndërmerr masa për të siguruar se llogaritë e arkëtueshme janë të evidentuara në bazë të faturimeve dhe që vlera e tyre shpalolet saktë në PFV	Komuna kishte marrë masa për ta adresuar këtë çështje.	I zbatuar

		pas harmonizimit të regjistrave nga drejtoritë përkatëse me ZKF-në.		
7	Obligimet e papaguara	Kryetari duhet të sigurojë që të gjitha faturat paguhen brenda afateve të parapara ligjore prej 30 ditësh.	Komuna nuk kishte marrë masa për ta adresuar këtë çështje.	Nuk ka filluar zbatimin
Nr	Fusha e auditimit	Rekomandimet e vitit 2020		
1	Të Hyrat	Kryetari duhet të siguroj se behën korrigjimet e nevojshme mbi të dhënat e zonave të vendosura në sistemin-protax, në përputhje me Rregulloren në fuqi, në mënyrë që ngarkesa tatimore të jete e saktë dhe e drejt për të gjithë obliguesit e tatimit në pronë.		
2.	Mallrat dhe Shërbimet	Kryetari duhet të sigurojë se çertifikimi i pagesave bëhet vetëm pasi lëndët të jenë kompletuar me dokumentacionin e nevojshëm. Obligimet financiare të paguhen brenda afatit ligjor, dhe se zotimi i mjeteve financiare në SIMFK ti paraprijë kërkesave për furnizim të mallrave dhe shërbimeve.		
3	Mallrat dhe Shërbimet	Kryetari duhet të sigurojë se menaxherët e kontratave mbikëqyrin dhe evidentojnë në raportet e pranimit dhe ditarin e punës sasinë e furnizimeve dhe shërbimeve të kryera. Kryetari në bashkëpunimin me kompaninë kontraktuese duhet të qartësojë aspektin e çmimit të kontraktuar dhe ti përmbahet çmimeve të kontraktuara sipas Marrëveshjes.		
4	Mallrat dhe shërbimet dhe komunalitë	Kryetari duhet të sigurojë se të gjitha shpenzimet regjistrohen në kategoritë dhe kodet përkatëse ekonomike.		
5	Subvencionet dhe Transferet	Kryetari duhet të sigurojë se procesi i përzgjedhjes së projekteve për financim të zhvillohet duke aplikuar të gjitha kërkesat dhe formatet/formularët standard të përcaktuara me Rregulloren MF-Nr. 04 2017 për subvencionim të OJQ-ve, si dhe duhet të shtojë masat e kontrollit në monitorimin e projekteve të financuara. Ndarja e detyrave dhe përgjegjësi të bëhet në pajtim me rregullat e MFK-së ashtu që zyrtarët të mos përfshihen në më shumë se në një fazë të procesit.		
6	Investimet Kapitale	Kryetari duhet të siguroj që nënshkrimi i kontratave bëhet në përputhje me fondet e buxhetuara dhe aprovuar, në mënyrë realizimi i projekteve të jetë sipas planit për të parandaluar shpenzime tjera shtesë.		
7	Pasuritë	Kryetari duhet të siguroj që komisioni për inventarizim të pasurisë të hartojë raportin për inventarizimin e pasurive para datës së përgatitjes së PFV-ve.		
8	Pasuritë	Kryetari duhet të marrë veprime të nevojshme për ta aplikuar sistemin e menaxhimit të pasurisë (e-pasuria), në mënyrë që të ketë një menaxhim dhe raportim të pasurisë në përputhje me kërkesat e rregullores për menaxhimin		

		e pasurisë jo financiare. Kjo çështje duhet të trajtohet edhe nga MAP, në mënyrë që ti mundësohet komunës që të funksionalizoj sistemin e-pasuria.
9	Pasuritë	Kryetari duhet të sigurojë se menaxhimi i automjeteve kontrollohet nga personat përgjegjës të emëruar paraprakisht të cilët aplikojnë dokumente dhe aprovojnë kërkesat sipas rregullave duke ofruar dëshmi përkatëse se veturat përdoren për nevoja të komunës. Furnizimi me derivate të bëhet në mënyrë të kontrolluar apo nga personat e paracaktuar dhe nevojës për riparimi të automjeteve duhet ti paraprijë kërkesa dhe bashkëngjitet aprovimi nga niveli përgjegjës.

Besnik Osmani, Auditor i Përgjithshëm



Emine Fazliu, Ndihmëse e Auditorit të Përgjithshëm



Luljeta Morina, Udhëheqëse e Auditimit



Lavdim Maxhuni, Udhëheqës i ekipit



Fetah Osmani, Anëtar i ekipit



Ilir Abazi, Anëtar i ekipit



Shtojca I: Letër konfirmimi

ОПШТИНА ГРАЧАНИЦА - КОМУНА Е ГРАЧАНИЦЕ - REPUBLIC OF KOSOVO



ОПШТИНА ГРАЧАНИЦА
KOMUNA E GRAÇANICËS
MUNICIPALITY OF GRACANICA

LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me gjetjet e Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2020 dhe për zbatimin e rekomandimeve

Për: Zyrën e Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Pasqyrave Financiare të Komunës së Graçanicës, për vitin 2020 (në tekstin e mëtejshëm "Raporti");
- **pajtohem me gjetjet dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit; si dhe**
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për zbatimin e tyre.


Z. Srdan Popović
Kryetari i komunës së Graçanicës

Data: 16.07.2021.



Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

Raporti i auditorit për pasqyrat financiare(*) duhet të përmbajë një shprehje të qartë të opinionit referuar pasqyrave financiare, bazuar në përfundimet e nxjerra nga provat e marra gjatë auditimit. Kur auditimi është kryer për të vlerësuar gjithashtu përputhjen me legjislacionin dhe rregulloret e tjera, auditorët kanë një përgjegjësi shtesë për të raportuar për pajtueshmërinë me autoritetet(*). Ky opinion duhet të ndahet nga opinioni nëse pasqyrat financiare janë të vërteta dhe të drejta, d.m.th. opinionin mund të modifikohet në lidhje me çështje (-t) e pajtueshmërisë, por ende janë të pamodifikuara në lidhje me besueshmërinë e pasqyrave financiare (ose anasjelltas).

Me qëllim të konstatimit nëse një opinion mbi pasqyrat financiare është modifikuar ose jo i modifikuar, një auditor duhet të sigurojë që rezultatet e auditimit përfshijnë ose jo materiale të zbuluara ose keq-deklarimit(-eve) të përhapur (-a) ose një (më shumë) të mundshëm të supozuar në rast të kufizimit të fushëveprimit.

Një keq-deklarim është një ndryshim midis shumës së raportuar, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit të një artikulli të pasqyrës financiare dhe sasisë, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit që kërkohet që artikulli të jetë në përputhje me kornizën e raportimit financiar në fuqi. Keq-deklarimet mund të vijnë nga gabimi ose mashtrimi.

(shkëputur nga SNISA 200)

Forma e opinionit

Opinionin i pa-modifikuar

Formulohet kur nuk janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri, ose janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri, një e vetme ose e agreguar, që nuk është e barabartë me ose nuk e tejkalon nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare në tërësi ose keq-deklarimi (-et) dhe/ose mos-pajtueshmëritë e zbuluara brenda një klase të caktuar të transaksioneve nuk është e barabartë ose e tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse nuk ka kufizim të fushëveprimit ose kur kufizimi i fushëveprimit nuk mund të çojë në shmangie të keq-deklarimit (-eve) material (-e) dhe/ose mos-pajtueshmërisë(-ve).

Kufizimi i fushëveprimit ndodh kur një auditor nuk është në gjendje të marrë prova të mjaftueshme të auditimit për të konkluduar se pasqyrat financiare në tërësi janë të lira nga keq-deklarimi material.

Auditori duhet të japë një **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Ndryshimet e opinionit në raportin e auditorit

Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit nëse konstatohet se, bazuar në provat e marra nga auditimi, pasqyrat financiare në tërësi nuk janë të lira nga keq-deklarimi material dhe/ose mos-pajtueshmëria ose nuk është në gjendje të sigurojë prova të mjaftueshme të auditimit të mjaftueshëm për të konkluduar se pasqyrat financiare në tërësi janë të lira nga keq-deklarimi material dhe/ose mos-pajtueshmëria, auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit. Opinionet e modifikuara mund të jenë:

- Të modifikuara (kualifikuara)
- Të kundërta, ose
- Të mohuara

Opinion i kualifikuar

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos pajtueshmëri, një e vetme ose një agregat, që është e barabartë ose e tejkalon nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si një e tërë ose kur keq-deklarimi (-et) dhe/ose mos-pajtueshmëritë e zbuluara brenda një klasë të caktuar të transaksioneve është i barabartë ose tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse nuk ka kufizim të fushëveprimit që nuk mund të çojë në shmangie të keq-deklarimit(-eve) material (-e).

Opinion i kundërt

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, një e vetme ose një agregat, që tejkalon në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si një e tërë ose kur keq-deklarimi (-et) dhe/ose mos-pajtueshmëritë e zbuluara brenda një klasë të caktuar të transaksioneve e tejkalon në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve.

“E përhapur” është term që përdoret në kontekstin e gabimeve dhe/ose mos-pajtueshmërive për të përshkruar efektet e gabimeve dhe/ose mos-pajtueshmërinë në pasqyrat financiare ose efektet e mundshme në pasqyrat financiare të gabimeve dhe/ose mos-pajtueshmërinë, nëse ka të tilla, që nuk zbulohen për shkak të pamundësisë për të marrë prova të mjaftueshme adekuate të auditimit. Efektet të përhapura në pasqyrat financiare janë ato që, sipas gjykimit të auditorit:

- a) Nuk kufizohen vetëm në elemente, llogari ose zëra të veçantë të pasqyrave financave
- b) Nëse kufizohen kështu, përfaqësojnë ose mund të përfaqësojnë një pjesë të konsiderueshme të pasqyrave financiare; ose
- c) Në lidhje me shpalosjet, janë thelbësore për kuptimin e pasqyrave financiare.

Mohim i opinionit

Formulohet kur kufizimi i fushëveprimit, d.m.th. kur pamundësia për të siguruar prova të mjaftueshme të përshtatshme të auditimit, është i natyrës materiale dhe e përhapur.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

Nëse auditori e konsideron të nevojshme për të tërhequr vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka prova të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keqdeklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë një paragrafi të Theksimit të Çështjes në raportin e tij. Paragrafët për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohen vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

Një paragraf i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

Nëse auditori e konsideron të nevojshme për ta komunikuar një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që ta kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje Të Tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të Çështjes.

Shënimet fundore

- ¹ Pajtueshmëria me autoritetet – pajtueshmëria me të gjitha ligjet, rregullat, rregulloret, standardet dhe praktikatat e mira relevante në sektorin publik
- ² Raportet tjera janë kërkesë e nenit 8 të së Rregullores 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar
- ³ Kolektivisht të referuara si pajtueshmëri me autoritetet
- ⁴ Çështja A dhe Rekomandimi A - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e reja
Çështja B dhe Rekomandimi B - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e përsëritura
Çështja C dhe Rekomandimi C- nënkupton çështjet dhe rekomandimet pjesërisht të përsëritura.
- ⁵ Vlera te tatim paguesit që ka ndodhur mbi faturimi duhet të jetë në shumë prej 41,166€, e jo siç është prezantuar ne faturën e TPr.(kartelën financiare) sipas Komunës në shumë prej 54,596€. Pra kemi mbi faturim prej 13,430€.
- ⁶ Buxheti Final – buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave
- ⁷ Pasqyrat financiare në sektorin publik përfshijnë po ashtu edhe pasqyrën(at) e ekzekutimit të buxhetit
- ⁸ Pajtueshmëria me autoritetet: pajtueshmëria me ligjet, rregulloret, standardet, apo praktikatat e mira.